



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 1584 Prot.

Tiranë, më 25.02.2015

**UDHËZIM**

Nr. 5, datë 25.02.2015

**PËR**

**“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.43, DATË 15.10.2014 TË  
MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT “PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE  
TËREGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË  
DYTË, TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI  
DHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË  
OFRUARA NGA KËTO INSTITUCIONE, PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015”, I  
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 33, pikës 1 të nenit 34 dhe nenit 35 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Pas pikës 3 të Udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, i ndryshuar, shtohet pika 3.1 si më poshtë:

*“3.1.Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit për transferimin e studimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2014-2015, në institucionet private të arsimit të lartë, të kryhen dhe në periudhën 25 Shkurt 2015 deri më 16 mars 2015.”.*

2. Pas pikës 5 të Udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, i ndryshuar, shtohet pika 5.1 si më poshtë:

*“5.1 IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), brenda datës 20 Mars 2015, listën e studentëve të regjistruar për transferim studimesh në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD). AKP-ja, brenda datës 20 Prill 2015 u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të private çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi, si dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP me listat me numrat e matrikullimit.”.*

3. Pas pikës 6 të Udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, i ndryshuar, të shtohet pika 6.1 si më poshtë:

*"6.1 IAL-të private, deri në datën 24 Prill 2014, dërgojnë zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat mbi regjistrimet e transferimit të studimeve të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë në formatet e kërkuara sipas Udhëzimit Nr. 9, datë 25.02.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore."*

4. Pika 17 e Udhëzimit Nr. 43, datë 15.10.2014, i ndryshuar, shfuqizohet.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

**LINDITA NIKOLLA**



**MINISTËR**

